



Viti 2022

Etika dhe integriteti i procesit zgjedhor për personat me aftësi të kufizuara



SHOQATA PËR PROMOVIMIN DHE ZHVILLIMIN E SHOQËRISË
INKLUZIVE INKLUZIVA

Titulli: Etika dhe integriteti i procesit zgjedhor për personat me aftësi të kufizuara

Botues: Shoqata për promovim dhe zhvillim të shoqërisë gjithpërfshirëse
INKLUZIVA

Autor: Bllagica Dimitrovska

Shtypi: „Grafoteks“ - Kumanovë

Hyrje Ky doracak ka për qëllim që të informojë personat me aftësi të kufizuara, për Etikën dhe Integritetin e procesit zgjedhor.



Procesi zgjedhor me etikë dhe integritet është proces në të cilin personat me aftësi të kufizuara kanë **të drejta të njeriut**, njësoj si dhe të gjithë qytetarët tjerë.



Ata janë të garantuara në **Marrëveshjet ndërkombëtare**, të cilat janë të detyrueshme për shtetet që i kanë nënshkruar dhe ratifikuar.

Marrëveshjet ndërkombëtare për të drejtat e njeriut të personave me aftësi të kufizuara në proceset zgjedhore janë:

- Deklarata universale për të drejtat e njeriut;
- Pakti ndërkombëtar për të drejtat civile dhe politike;
- Konventa evropiane për të drejtat e njeriut;
- Karta e të drejtave themelore e Bashkimit Evropian, dhe

Konventa e Combine të Bashkuara për të drejtat e personave me aftësi të kufizuara

Ky dokument është ratifikuar në Kuvendin e Maqedonisë së Veriut në 5 dhjetor të vitit 2011.



Konventa është një përmbledhje e të drejtave për personat me aftësi të kufizuara.



Ajo nuk parasheh Ligje të reja, por kërkon që të përmirësohen ligjet ekzistuese. Respektivisht, qytetarët të mos trajtohen ndryshe ose në mënyrë të padrejtë, për shkak të aftësive të tyre të kufizuara.

Konventa thkeson se shtetet nënshkruese sigurojnë Ligj dhe masa, me të cilat të gjithë qytetarët me aftësi të kufizuara, në bazë të njëjtë me të tjerët, do të gëzojnë **të drejtat politike**.



Të drejtat politike

Të qytetarëve me aftësi të kufizuara, të **zgjedhin**, të kandidohen, të vëzhgojnë dhe të ushtrojnë funksione publike, nuk duhet të dallohen nga të drejtat e të tjerëve



E drejta në zgjedhje është:

E drejtë zgjedhore.

E drejta zgjedhore realizohet në ditën zgjedhore, kur nga listat e



kandidatëve, zgjedhësit zgjedhin se

kush do të menaxhojë me vendin e tyre ose me qytetin e tyre.

Personat me aftësi të kufizuara, si dhe të gjithë të tjerët, duhet të **kandidohen** dhe zgjidhen për ushtrimin e funksioneve publike, nëse në zgjedhje fitojnë numër të mjaftueshëm të votave.

E drejta për të kandiduar në zgjedhje,

Qytetarët me aftësi të kufizuara, e realizojnë këtë të drejtë në mënyrë të pavarur apo përmes **partisë politike.**



Partia politike

është grup i njerëzve që kanë ide të ngjajshme për politikën dhe ligjet në shtet.

Si anëtarë të partive politike, personat me



aftësi të kufizuara munden/duhet të jenë pjesë e trupave partiake, të marrin vendime partike dhe të zgjidhen për të qënë lider partiak. Politikanët me aftësi të kufizuara, kanë të drejtë të jenë kandidat në listat zgjedhore nga partia në të cilën janë anëtarë. Listat për kandidat vërtetohen nga **organet e zgjedhjeve**.

Organet e zgjedhjeve

të cilat organizojnë dhe zbatojnë zgjedhjet janë:



- **Komisioni shtetëror i zgjedhjeve.**
- Komisionet komunale të zgjedhjeve dhe këshillat zgjedhor.

Personat me aftësi të kufizuara kanë të drejtë të jenë pjesë e organeve të zgjedhjeve, respektivisht të organizojnë dhe zbatojnë **ciklet zgjedhore**.

Ciklet zgjedhore janë:

përmbledhje e aktiviteteve të lidhura ndërmjet veti, në periudhat e caktuara kohore. Pjesëmarrja e personave me



aftësi të kufizuara në çdo periudhë, do të përmirësojë qasshmërinë dhe disponueshmërinë e procesit zgjedhor, me çrast do të rritet etika dhe integriteti i të njëjtit. Proceset zgjedhore ndiqen nga ana e personave të autorizuar të cilët kanë:

Të drejtën e vëzhgimit!

Vëzhgimi i zgjedhjeve ndikon në mënyrë të drejtëpërdrejtë në avancimin e të drejtave zgjedhore të qytetarëve.



Vëzhguesit me aftësi të kufizuara kanë të drejtë që të vëzhgojnë të gjithë procesin zgjedhor. Përmes



njoftimit të drejtëpërdrejtë, për problemet e vërtetuara të votuesve me aftësi të kufizuara dhe dhënien e rekomandimeve për tejkalimin e tyre, kontribuojnë për zgjidhjen e të njëjtave.

Çfarë duhet të përmirësohet?

Pjesëmarrja e personave me aftësi të kufizuara, në proceset zgjedhore është vështirësuar.



Përmirësimet e nevojshme janë:

Korniza zgjedhore juridike, të harmonizohet me dispozitat e Konventës të KB, për të drejtat e personave me aftësi të kufizuara!



Të sigurohet që personat me aftësi të kufizuara intelektuale dhe psikosociale, të gëzojnë aftësinë për punë dhe të drejtën në zgjedhje.



Personave me aftësi të kufizuara të cilët jetojnë në institucione për kujdes jashtë familjar t'u



mundësohet që të votojnë!

Të vendosen kuota për përfaqësimin e personave me aftësitë e kufizuara, në organet e zgjedhjeve dhe në listat për kandidat për zgjedhjet parlamentare dhe lokale!



Partitë politike të hartojnë fushata për qasshmëri dhe disponueshmëri në vendet për takime dhe ngjarje.



Të evidentohet numri i personave me aftësi të kufizuara, të cilët marrin pjesë në procesin politik dhe zgjedhor!



Të sigurohet qasshmëri në vendet zgjedhore dhe objektet publike.



Informatat për pjesëmarrje në proceset politike dhe zgjedhore që të jenë lehtësisht të kuptueshme.



Personat me aftësi të kufizuara dhe përfaqësuesit e tyre, të përfshihen në konsultime, gjatë marrjes të vendimeve, për të drejtat dhe proceset zgjedhore!



Të parashihen mjetet buxhetore, për mbështetje të kandidatëve me aftësi të kufizuara.



Të nxitet dukeshmëria dhe pjesëmarrja e personave me aftësi të kufizuara në debatet zgjedhore dhe emitimin e programeve politike në media në format e disponueshme.



Me përfshirjen aktive të personave me aftësi të kufizuara në procesin politik dhe zgjedhor kontribuohet jo vetëm për zgjidhje më të mira ligjore dhe politike për personat me aftësi të kufizuara por sigurohet shoqëri më e mirë për të GJITHË!

Shoqata për promovimin dhe zhvillimin e shoqërisë inkluzive INKLUZIVA

E-mail: inkluziva@gmail.com



Ueb: <http://inkluziva.mk>



